



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 108/2018
Datë: 23 shkurt 2018

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe në bazë të nenit 4 të Rregullores Nr.03/2016 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur me datë 23 shkurt 2018, mori këtë:

VENDIM

- I. Për shpalljen e brendshme për tetë (8) pozita për avancim të prokurorëve të shtetit, si në vijim:
 1. Tri (3) pozita në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit;
 2. Një (1) pozitë në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore Prishtinë;
 3. Tri (3) pozita në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore Mitrovicë, dhe
 4. Dy (2) pozita në Prokurorinë Themelore Ferizaj, një (1) pozitë në Departamentin për Krime të Rënda dhe një (1) pozitë në Departamentin për të Mitur.
- II. Shpallja duhet të përmbajë informatat e përcaktuara në Rregulloren Nr.03/2016 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit.
- III. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim dhe Shpalljen për avancim t'i publikojë në faqet zyrtare të KPK-së dhe PSH-së.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Blerim Isufaj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- ZKPSH;
- Kryeprokurorit të PTh Prishtinë, Mitrovicë dhe Ferizaj
- Sekretariatit;
- Arkivit të KPK-së.